

Data ___/___/2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: BLERJE DRU ZJARRI

(“Prodhim, transport ,shkurtim-çarje dhe magazinim pranë institucioneve në varësi të bashkisë Tropojë të sasisë 1363m3(2276mst) dru zjarri”).

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 03413000-08

VLERA E FONDIT LIMIT:

4,373,290 lekë (Pa TVSH). Katër milion e treqind e shtatëdhjetë e tre mijë e dyqind e nentëdhjetë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19/05/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor _Bashkia Tropojë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojces 8.
- c. Formulari ofertes sipas Shtojces 1.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19/05/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): Operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë prokurim duhet që të plotësojnë kapacitet ligjore, teknik dhe profesionale për kryerjen e këtij prokurimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19/05/2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

(Shenim: Përcaktoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nenligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kerkese specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).

1. Subjekti privat të paraqes kontratë të nënshkruar me inxhiniero-teknik profesional me CV, dhe Diplome(Inxhinieri Pyjore)

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiros vjetore për vitet financiare(2020-2021-2022), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e fondit të parashikuar të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19/05/2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë specifikën e mallrave objekt procedure prokurimi ,kërkohet që OE Ofertues të paraqes OE se disponon *kapacitet të nevojshëm ekonomik dhe financiar për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara.Për këtë,OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik sipas përcaktimit të viteve të kërkuara për përgaditjen e vërtetimit të xhiros vjetore bazuar në dispozitat e legjistacionit nr.8438, datë 28/12/1998 "Për tatimin mbi të ardhurat ",i ndryshuar.Udhezimet të Ministrit të Financave nr.5 date 30/01/2006 "Për tatimin mbi të ardhurat".i ndryshuar VKM-së nr.922 date 29/12/2014 "Për deklarimin e detyrueshme të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore vetëm nëpër mjet të formes elektronike"*

Shenim: Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bazuar . Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet autoritetet-enet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020- 2021-2022, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, vetëm në rastin kur

janë në kushtet e përcaktimeve , ku bilanci e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19/05/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke marrë në konsideratë specifikën e mallrave objekt prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqet se disponon kapacitet të nevojshëm ekonomik dhe financiarë për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara .Për këtë,OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik sipas përcaktimit të viteve të kërkuara për përgaditjen e vërtetimit të xhiros vjetore bazuar në dispozitat e legjislacionit nr.8438,date 28/12/1998 ”Për tatimin mbi të ardhurat ”.I ndryshuar ,Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, date 30/01/2006 ”Për tatimin mbi të ardhurat”. I ndryshuar,VKM-Së NR.922 date 29/12/2014 ”Për deklarimin e detyrueshem të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjerave tatimore, vetëm nëpër mjete të formës elektronike”.

(Shënim: Citoni dispozitat perkatëse të legjislacionit tatimor, ku pasqyrohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabel ose shoqëri audituese).

2.2.3 Vërtetimi të lëshuar nga autoritetet vendore,për shlyrjen e taksave vendore të parashikuara për vitin 2022 ose 2023(Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23/12/2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19/05/2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së përlllogaritur të kontrates, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës” e VKM-Së NR.285, datë 19/05/2021, ku përcaktohet .Autoriteti-enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës ,ku të shënohen vlera ,afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjilacionit në fuqi, ku shënohen datat , shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Shenim: Duke qene se aktet ligjore dhe nenligjore parashikojne nje marzh per vleren e kontratave te ngjashme qe mund te kerkohet, autoritete/ente kontraktore duhet te argumentojne vleren e kerkuar te kontrateve te ngjashme brenda ketij marzhi.

Shenim: Autoriteti/enti kontraktor mund te kerkoje edhe:

1. Operatori Ekonomik duhet te kete numrin e nevojshem per 2 (dy) punonjes te siguruar per muajin korrik-gusht 2023 per zbatimin e kontrates.
 - a) Kjo te deshmohet me vertetim te leshuar nga Administrata Tatimore per numrin e punonjesve te siguruar (**Formulari E-SIG 02/a**) te shoqerohet me formularet E-SIG 025/a

(Per plotesimin e kriterit te mesiperme eshte e mjaftueshme paraqitja e deklarates sipas shtojces Nr.8 (Formulari permbledhes i vetedeklarimit).

Ne lidhje me momentin e paraqitjes se dokumentacionit deshmues per kerkesat qe perfshihen ne formularin permbledhes te vetedeklarimit, mbajme ne konsiderate percaktimet e nenit 26, pika 6, te VKM 285, DT.19.05.2021, i ndryshuar , ku parashikohet qe “Perpara publikimit te njoftimit t e fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kerkon ofertuesit te kualifikuar i pari dorezimin e dokumenteve provuese te parashikuara ne shkronjar “a”, “b”,,”d”, “dh”, “e”, “h”,”i”, “j”, te pikes 2 te ketij neni , si dhe dokumentet e tjera shoqeruese te ofertes, te dorezuara ne rruge elektronike. Keto dokumente duhet te paraqiten ne original ose ne kopje te njehsuara me origjinalin

2. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë një staf punonjësish prej **2(dy) -- persona. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.**
-
-

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKMnr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

3. Kërkesa te tjera te vecanta per kualifikim

3.1.Operatori ekonomik duhet të disponoje mjetet e nevojshme per reaëizimin e kontrates. Per kete duhet te paraqese deshmi te pakten 2(dy) automjete (pronesi ose qera), automjetet transporti mni 5 ton.

Per te deshmuar kete, operatore ekonomike duhet te paraqesin dokumentat e meposhteme:

- a) Per mjetet qe shenohen ne regjistra publike, nese jane ne pronesi, duhet te paraqiten dokumenta qe vertetojne regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikata e kontrollit teknik, polica e sigurimit vjetor.
- b) Per mjetet qe shenohen ne regjistra publike, nese jane me qera, duhet te paraqiten dokumenta qe vertetojne regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikata e kontrollit teknik, polica e sigurimit vjetor, si dhe kontrata perkatese e qerase. Te jene te pajisur me leje drejtimi te kategorise perkatese te mjeteve te mesiperme.

3.2 a) Operatori Ekonomik duhet te zoteroje dhe te paraqesë lnje certifikate ISO 9001-2015 te vlefshme ose ekuivalente per sistem menaxherale te cilesise, ose ekuivalente me te ose Operatori ekonomik duhet të zotërojë dhe të paraqes një çertifikatë ISO 14001-2015 të vlefshme ose ekuivalente për sistem menaxherial të cilësisë,ose ekuivalente me te.

Argumentimi: Kërkesa ne lidhje me keto certifikata eshte ne perputhje me nenin 44, te V KM Nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", dhe nenin 79, te Nr. 162, date 23. 12.2020 "Per prokurimin publik"si dhe ne lidhje me licensen profesionale Eshte mbështetur ne nenin 40 pika 5/c i VKM nr. 285 , date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik".

(Shënim: Autoriteti/enti kontraktor, ne varesi te natyres se objektit te prokurimit, mund te percaktoje kriteret te tjera te vecanta, te cilat i vlerëson te nevojshme për ekzekutimin me sukses te kontrates, duke argumentuar teknikisht dhe ligjërisht sdo kriter, duke përcaktuar, sipas rastit, aktin ligjor /nenligjor ge parashikon domosdoshmërine e kriterit në fiale).